



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 21.12.2013, ora 9.00

Drejton mbledhjen:

Vasilika Hysi – kryetare e Nënkomisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore për projektbuxhetin 2014 me shoqata që operojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe grave .

Marrin pjesë:

Vasilika Hysi, Arben Ristani, Kastriot Islami
(E pranishme deputetja Mimoza Hafizi)

Mungojnë:

Ermonela Felaj, Luan Duzha.

Të ftuar:

Arbër Mazniku – zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit
Florian Nuri – drejtor i Financës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit
Gentian Opre – drejtor i Analizës dhe Programimit Buxhetor, Drejtoria e përgjithshme e Buxhetit, Ministria e Financave
Mirela Arqimandriti – përfaqësuese nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
Iris Luarasi – përfaqësuese nga Linja e Këshillimit për Gra e Vajza
Mrikë Cara – përfaqësuese nga Shoqata për Integrimin e Grave në Zonat Informale

Stela Tanellari – përfaqësuese ngaoraganizata “Të ndryshëm, por të barabartë”
Ines Leskaj – përfaqësuese nga Rrjeti për Fuqizimin e Gruas Shqiptare
Edlira Cepani – përfaqësuese nga Rrjeti Barazi në Vendimarrje
Sevim Arbana – përfaqësuese nga shoqata “Në dobi të gruas shqiptare”
Linda Bushati – përfaqësuese nga UNICEF-i
Altin Hazizaj – përfaqësues nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
Belioza Coku – përfaqësuese nga “ALO 116” Linja Kombëtare e telefonit të fëmijëve
Rajmonda Bozo – përfaqësuese e Shërbimit Ligjor falas
Daniela Shkalla - përfaqësuese nga shoqata “Bashkë për kujdesin tërësor të fëmijëve”
Adriatik Hasantari – përfaqësuese nga organizata Roma Active Albania
Ani Rusi – përfaqësuese nga shoqata “Refleksione”,

HAPET MBLEDHJA

Vasilika Hysi - Mirëmëngjesi!

Kuorumi i nënkomisionit të të Drejtave të Njeriut është bërë. Në emër të Aleancës së Grave Deputete, na nderon zonja Mimoza Hafizi, nënkryetare e Aleancës. Gjithashtu, edhe zonja Mesila, kryetare e Aleancës së Grave Deputete ka konfirmuar që do të vijë.

Dua të falënderoj përfaqësuesit e shoqërisë civile, konkretisht: përfaqësuesit e shoqatave të fëmijëve dhe grave, për pranimin e ftesës sonë për një seancë dëgjimore lidhur me diskutimin e projektbuxhetit nga këndvështrimi i interesit më të lartë të fëmijës dhe i të drejtave të grave.

Numri i shoqatave që veprojnë në këtë fushë është i madh dhe ne nuk kemi arritur t'i ftojme të gjitha. Ndaj besojmë se do të na mirëkuptojnë. Gjithsesi, ne do të përpiqemi që të plotësojmë *database*-in në Kuvendin e Shqipërisë për të pasur listën e të gjitha organizatave që janë aktive në fushën e të drejtave të grave dhe të fëmijëve.

Gjithashtu, ju kërkojmë ndjesë për kohën e shkurtër, por siç e dini planifikimi i buxhetit ka pasur specifikat e veta. U desh të bënim negociata me FMN-në. Nga ana tjetër, vendosëm që këtë seancë dëgjimore ta zhvillojmë sot në fundjavë, për arsye se buxheti do të miratohet në parim ditën e hënë në parlament. Ditën e martë projektbuxheti do të diskutohet nën për nën nëpër komisione.

Gjithashtu, dua të them se ky projektbuxhet është diskutuar edhe në komisionet e përhershme parlamentare. Shumë nga çështjet, që lidhen me gratë dhe me fëmijët, janë diskutuar në seanca dëgjimore, i kemi diskutuar me përfaqësuesit e ministrive, të institucioneve të pavarura dhe institucioneve të tjera kushtetuese. Në këtë kuadër ka linja ose zëra të buxhetit që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me gratë dhe fëmijët. Ne kemi parashtruar pyetje dhe kemi lobuar fort në komision për të rritur buxhetin. Në rast se ju do të keni ndonjë paqartësi, ju lutem, mos ngurroni t'i shprehni ato.

Gjithashtu, dua t'ju vë në dijeni se për të sqaruar më mirë këto probleme dhe çdo paqartësi kemi ftuar edhe përfaqësuesin e Ministrisë së Financave, zotin Gentian Opre, drejtor i analizës dhe i programimit buxhetor në drejtorinë e përgjithshme të buxhetit. Njëkohësisht, nga Ministria e Arsimit dhe e Sporteve kemi ftuar zotin Arbër Mazniku, të cilin e falënderoj.

Më lejoni të falënderoj ministrat e linjës, pasi më kanë sjellë me shkrim një raport të detajuar të buxhetimit për interesin e grave dhe të fëmijëve. Konkretisht: Ministria e

Shëndetësisë, Ministria e Mirëqenies dhe e Rinisë, Ministria e Arsimit dhe e Sporteve, Ministria e Zhvillimit Urban. Pra, kemi disa informacione që janë të dobishme që nxjerrin në pah buxhetimin gjinor për interesin e fëmijëve. Gjithashtu, në dijeninë time një pjesë prej jush kanë qenë të ftuar në seanca dëgjimore në disa ministri të linjës dhe se një pjesë e juaja kanë qenë të konsultuar.

Në këtë proces konsultativ janë ftuar organizata shqiptare, organizata që operojnë edhe si donatorë dhe organizata në terren. Ne kemi marrë mendime me shkrim nga katër organizata: nga *Save the Children*, nga *Le Terre de Enfants*, nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe nga *World Vision*. Nuk e di nëse janë të pranishëm, sepse kanë konfirmuar që e kanë të pamundur të marrin pjesë. Gjithsesi opinionet e tyre i kanë sjellë me shkrim dhe i kemi të depozituara në sekretariatit e nënkomisionit.

Në fund të kësaj seance dëgjimore ne do t'ju dërgojmë procesverbalin në adresat tuaja të *e-mailit* dhe do t'ju mbajmë në kontakt se çfarë do të marrë në konsideratë Komisioni i Ekonomisë dhe i Financave.

Ju falënderoj edhe njëherë!

Tani dua t'ia jap fjalën zonjës Mimoza Hafizi.

Mimoza Hafizi – Faleminderit, zonja Hysi!

Faleminderit, zonja dhe zotërinj të pranishëm!

Ju falënderoj për mirëkuptimin dhe dashamirësinë që patët për të zhvilluar këtë aktivitet bashkërisht me Aleancën e Grave Deputete! Ju kërkoj ndjesë që po ju angazhojmë shumë në këtë aktivitet, por është një periudhë shumë intensive e miratimit të buxhetit.

Një nga shtyllat e objektivave tona kemi asistencën për gratë e kërcënuara, familjet në rrezik dhe fëmijët. Jemi munduar që përtej çdo dallimi politik të përafrojmë gjithçka që kanë programet e partive politike për këtë çështje dhe duket se programet e partive politike për çështjen e fëmijëve dhe të grave janë krejtësisht të përafërta dhe të ngjashme. Ne na konsideroni si aleatët tuaj. Ne jemi krijuar për këtë qëllim të ndihmojmë shoqërinë shqiptare që të përballojë sa më mirë problematikën aktuale.

Këtu ka ardhur edhe zonja Kryemadhi, e cila është bashkëdrejtuese e Aleancës dhe është shumë aktive për këtë çështje. Ne jemi këtu për t'ju ndihmuar dhe bashkë me nënkomisionin do të jemi mbështetja juaj që viti 2014 të shënojë hapa pozitive në këtë çështje.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Dua të them dy rregulla teknike. Seancën dëgjimore duhet ta mbyllim në orën 10:30, sepse ka aktivitete të tjera dhe duam të fitojmë kohën e konsultimit me Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave.

Kam një sugjerim, mendoj që të fillojmë me përfaqësuesit e shoqatave të fëmijëve dhe pastaj të kalojmë te shoqata e grave. Do të ishte mirë që të mos përsërisim njëri-tjetrin.

Ju vë në dijeni se ditën e hënë në seancë plenare miratohet Nënkomisioni i të Drejtave të Grave, të Fëmijëve dhe i Dhunës në Familje, që do të jetë në përbërjen e Komisionit të përhershëm të Çështjeve Sociale dhe të Shëndetësisë.

Zoti Hazizaj, urdhëroni!

Altin Hazizaj – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Quhem Altin Hazizaj, jam drejtori i përgjithshëm i Qendrës për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri. Dua të falënderoj Kuvendin, si dhe të vlerësoj proceset pozitive që kanë filluar në lidhje me konsultimet e shoqërisë civile.

Gjithashtu, dua të përgëzoj të gjitha ministrinë e linjës që kanë pasur mundësi të konsultohen me ne në lidhje me çështjet buxhetore por jo me të gjithë buxhetin. Përpara se të paraqes disa nga çështjet që janë të rëndësishme për buxhetin e shtetit, do të kërkoja nga komisioni që buxheti i vitit të ardhshëm të mos vijë me kaq vonesë për konsultim, sepse ne nuk kemi mundësi të angazhojmë burimet e duhura njerëzore që të japim mendimet profesionale në këtë drejtim. Mendoj se duhet të jetë një periudhë 6-mujore që ne të marrim buxhetin për të pasur një mundësi vërtet serioze për të diskutuar.

Sot do të flas për çështjen mbi të drejtat e fëmijëve nisur edhe nga fakti që parlamenti ka miratuar një rezolutë për të drejtat e fëmijëve.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe e Rinisë këtë vit ka parashikuar të krijojë një fond të posaçëm për mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile. Ne na është bërë e qartë, por në buxhet kjo nuk del si zë specifik. Nga ana tjetër, shqetësimi parësor ka të bëjë me faktin se fondi i parashikuar është rreth 30 milionë lekë, që ne si organizatë e gjejmë të papërshtatshme për të mbuluar nevojat për financimin e shërbimeve që ofron sot shoqëria civile për gratë dhe fëmijët në Shqipëri.

Një fond prej 30 mijë lekësh nuk është i mjaftueshëm, sepse sot 86% e shërbimeve në nivel kombëtar dhe lokal financohen dhe mbulohen drejtpërdrejtë nga shoqëria civile.

Së dyti, në buxhetin e shtetit nuk bëhet e qartë sa është fondi për shoqërinë civile në lidhje me AMSHC ose fondin e shoqërisë civile, që funksionon pranë zyrës së Kryeministrit. Na është premtuar që vitin e ardhshëm ky buxhet mund të ishte midis një deri në 2 milionë dollarë, por në buxhet nuk dilte e qartë, por ndoshta mund të dalë gjatë sqarimit që do të bëjmë.

Çështje tjetër që përbën shqetësim është edhe çështja e financimit të organizatave vendase. Në takimin që kemi pasur me Ministrinë e Mirëqenies Sociale fondi nuk është caktuar nëse do të ndahet edhe për organizatat ndërkombëtare ose vetëm për ato vendase. Pra, ka një paqartësi. Ne do të kërkonim që në buxhetin e shtetit të vendoset një referencë që përfituesit e fondeve të buxhetit të shtetit të jenë vetëm organizatat vendase dhe jo ato të huaja.

Do të kaloj pak te çështja e buxhetit për arsimin që prek ministrinë e Arsimit dhe jam i lumtur që Arbri është këtu. Ajo që ne sot kërkojmë publikisht ka të bëjë me dyfishimin e buxhetit të arsimit për fëmijët. Pra, nga 2.7%, në mos gaboj, që ka qenë në vitin 2013 ne duam që të shkojë 5%, sepse për mua është e patolerueshme që sot fëmijët të shkojnë në shkollë të pangrënë; ka fëmijë që kanë nevojë për ndihmë psikologjike dhe nuk marrin këtë ndihmë; ka fëmijë që shkojnë të paveshur në shkollë dhe përjashtohen, sepse janë të paveshur. Pra rritja e një buxheti të arsimit duhet të shkojë për fëmijët që janë në nevojë. Rritja e nivelit të mbështetjes së fëmijëve automatikisht rrit nivelin e cilësisë së arsimit.

Një shqetësim tjetër, dhe besoj se kam edhe mbështetjen e krytares së seancës, është çështja e buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme. Në buxhet ne nuk gjetëm një fond specifik qoftë edhe të shpjeguar, se çfarë do të bëjë Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Brendshme në lidhje me kriminalitetin fëmisor dhe rinor. Në qoftë se shikojmë të gjitha të dhënat zyrtare për sa i përket kriminalitetit fëmisor dhe rinor, do të shikojmë se në buxhet nuk kemi asnjë masë në lidhje me parandalimin e këtij kriminaliteti, i cili po rritet shumë në Shqipëri. Thujse çdo vit është rritur me 30% dhe në qoftë se do ta krahasojmë me 5 vjetët e mëparshme kemi një dyfishim të kriminalitetit si të fëmijëve, ashtu edhe të të rinjve.

Së fundi, dua t'ju kërkoj sot publikisht, e kemi diskutuar edhe në seanca të tjera dëgjimore, mbështetjen tuaj në lidhje me një projektligj që ne po e propozojmë dhe duam të jetë një nismë e Kuvendit që ka të bëjë me mbështetjen dhe financimin me fonde shtetërore të programeve dhe projekteve vendase. Unë kam një kopje të këtij projektligji. Është përgatitur nga zyra jonë dhe dua t'ju shpjegoj shkurtimisht pse duhet kjo gjë.

Flasim për fonde që do t'i jepen shoqërisë civile nga një sërë ministrish, por, nga ana tjetër, të gjithë e dimë shumë mirë se sot qeveria shqiptare dhe ministrinë e linjës nuk kanë një mekanizëm të ndarjes së fondeve që garanton ndarjen e drejtë dhe transparente të këtyre fondeve. Ndaj ky projektligj vendos makinën e financimit të OJF-ve me fonde të buxhetit të shtetit dhe i jep zgjidhje problemit që ekziston në Shqipëri prej 23 vjetësh, ku qeveria e ka pasur të pamundur të financojë OJF-të për shërbimet e tyre nëpërmjet fondeve të ministrive.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Hazizaj!

Kush e do fjalën? Po, zonja Bushati, urdhëroni!

Linda Bushati – Përshëndetje!

Jam Linda Bushati nga organizata UNICEF. Para së gjithash, më lejoni t'ju falënderoj për ftesën e Nënkomisionit të Drejtave të Njeriut për të dhënë sugjerimet tona në lidhje me buxhetin e vitit 2014. Ashtu siç tha edhe kolegu im pak më parë, për ne ka qenë pak e vështirë të analizohej ky buxhet në një kohë kaq të shkurtër. Megjithatë disa nga komentet specifike që ne kemi sot për ministrinë e linjës janë si më poshtë:

Do të nisja me arsimin. Para së gjithash, dua të them se 85% e buxhetit të arsimit sot shkon për arsimin e detyrueshëm dhe atë të mesëm që në një farë mënyre i afrohet shumë detyrimit që ka shteti kundrejt fëmijëve. Dy nga sugjerimet që ne kemi për buxhetin, me aq sa jemi njohur nga media dhe nga diskutimet që janë bërë nga grupet e tjera janë këto:

E para, në buxhetin e vitit 2014 kemi një buxhet total për arsimin parashkollor dhe për arsimin bazë. Një nga komentet që kemi bërë në vazhdimësi Ministrisë së Arsimit dhe do të dëshironim shumë që kjo gjë të reflektohej në vitin 2014 është rëndësia e arsimit parashkollor për të ardhmen e fëmijëve. Është shumë e rëndësishme që t'i jepet prioritet kësaj grupmoshe.

Gjëja e parë që mund të sugjeroj për Ministrinë e Arsimit është që të ketë një linjë buxhetore të ndarë të arsimit parashkollor nga ai bazë. Nga studimet që ne kemi bërë del se buxheti për këtë grupmoshe është rreth 5%. Nuk e di nëse këtë vit ka ndryshime ose nëse është kalkuluar ky ndryshim. Që të arrihen objektivat e Ministrisë së Arsimit për këtë grupmoshe duhet që ky buxhet të shkojë minimumi deri në 13%.

Ne e mirëpresim faktin që Ministria e Arsimit ka parashikuar bursa për kategoritë në nevojë kryesisht për studentët romë. Sugjerimi ynë është se kjo mbështetje duhet të fillojë në moshë të hershme, pra, të shtrihet që nga parashkollori deri në shkollën e mesme.

Gjithashtu, dua të nënvizoj faktin se zgjidhjeve për grupet vulnerabël u ka kaluar koha. Ato duhet të jepen me zgjidhje të ndara. Pra, në një moment të japin bursa, në një moment tjetër të japin tekste shkollore e kështu me radhë. Kjo nuk do të zgjidhej kurrë nëse nuk do të mendonim për një lloj formule, që nuk jepet thjesht për nxënës, por është një formulë që parashikon profilin e grupeve sociale. Në qoftë se kemi një komunitet rom, sigurisht është më e shtrenjtë t'i arsimosh. Në qoftë se kemi grupe nga fëmijët me aftësi të kufizuara, sigurisht kanë kërkesa të tjera dhe është më e shtrenjtë për t'i arsimuar.

Në lidhje me Ministrinë e Drejtësisë kam një pyetje, sepse nuk e kemi të qartë. Në linjat e buxhetit që pamë, Ministria e Drejtësisë nuk ka të parashikuar asgjë për ndihmën ligjore falas. A do të alokohen fonde për këto grupe në nevojë, duke ditur rëndësinë që ka ndihma ligjore për këto grupe në nevojë?

Te Ministria e Brendshme. Në fakt jemi njohur më shumë nëpërmjet medias me faktin e një debati që ka qenë për heqjen e rreth 50 mijë lekve që i jepej çdo prindi kur lind një fëmijë. Në të gjitha dokumentet që janë analizuar për buxhetimin e fëmijëve kjo ka qenë një nga gjërat pozitive dhe mendoj se duhet të vazhdojë. Të gjithë i dimë shtrëngesat në buxhet, por nëse do të kishte mundësi t'u jepej grupeve më vulnerabël nëse nuk mund t'u jepet të gjithëve.

Te Ministria e Mirëqenies Sociale. Shikojmë se ka një buxhet për përfshirjen sociale. Duke qenë se ne kemi shumë strategji ndërsektoriale, që kanë të bëjnë me përfshirjen sociale, për shembull: përfshirjen e Shqipërisë në Dekada Rome, në strategjinë rome e të tjera, parashikohet që të ketë buxhete qoftë në linjat e tjera të ministrive, pra, arsimit shëndetësia etj., etj., qoftë te pushteti lokal. Pyetja është: A janë të parashikuara fonde për tezën pra, për Dekadën Rome, për strehimin, për shëndetësinë, për arsimin etj., brenda linjave të ministrive dhe brenda ndonjë transferte që bëhet për pushtetin lokal?

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Dua të bëj një saktësim. Lidhur me ndihmën juridike falas këtë pyetje e keni shtruar edhe në Komisionin e Ligjeve me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë. Na u tha se është parashikuar. Ndërkohë, ne sugjeruam që të parashikohen fonde edhe për 6 zyrat rajonale që do të hapen për shkak të ndryshimeve që kemi bërë vjet në ligj vjet.

Gjithashtu, lidhur me 50- mijëlekëshin për çdo lindje ne e diskutuam edhe dje në Komisionin e Ligjeve ku ishte i ftuar zoti Tahiri.

Zoti Tahiri dhe zonja Dhëmbi, përfaqësuesja e Ministrisë së Financave, na konfirmuan se buxheti është, por ministri i Brendshëm sugjeroi që ky fond të kalohej për të bërë përmirësimin e adresave dhe gjendjes civile për të saktësuar se ku jetojnë fëmijët romë. Borxhi që është lënë në vitin 2008 është 5.3 miliardë. Pra, është shumë i madh. Kjo pagesë nuk është paguar.

(Diskutime pa mikrofon.)

Vasilika Hysi - Nuk është paguar. Ndërkohë, është parashikuar...

(Diskutime pa mikrofon.)

Vasilika Hysi –Fjalën e ka zonja Bozo

Rajmonda Bozo – Faleminderit, zonja Hysi!

Ju falënderoj për ftesën! Jam sot këtu në emër të koalicionit të organizatave për të drejtat e fëmijëve dhe si drejtuese e shërbimit ligjor falas në Tiranë. Meqenëse çështja u prek edhe nga Linda, dua të përqendrohem pak më shumë në çështjen që i referohet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, që ka të bëjë me aksesin në drejtësi dhe me zbatimin e ligjit për ndihmën juridike.

Këto vite kanë qenë pothuajse vite të humbura për zbatimin e këtij ligji dhe nuk i është dhënë asnjëherë rëndësia e duhur, duke harruar një element shumë të rëndësishëm që prek të drejtat e fëmijëve dhe të grave. Pa pasur një status ligjor, nuk mund të përfitosh shërbime sociale. Në rast se gratë, fëmijët, familjet në nevojë nuk kanë akses në shërbimin ligjor falas mbështetur nga shteti, ata do të mbeten invizibël për shumë shërbime sociale dhe përkujdesje të tjera sociale, gjë që ka ndodhur faktikisht.

Pse unë e bëra këtë hyrje? Dua të them se shërbimi për ndihmën juridike falas është shumë i copëtuar dhe nuk e di nëse do të rregullohet për vitin 2014. Në ç'kuptim? Në qoftë se marrim çështjet penale, ato janë çështje që përballohen ose të them më mirë duhet t'i marrë përsipër prokuroria dhe zyra e administrimit të gjyqësorit për caktimin e avokatëve, por cilësia lë për të dëshiruar. Sipas ligjit "Për ndihmën juridike" duhet që çështjet penale dhe çështjet civile të administrohen nga komisioni shtetëror për ndihmën juridike. Në këtë buxhet, që është alokuar nga Ministria e Financës, nuk bëhet fjalë të bëhet një rregullim i tillë koordinativ midis buxhetit për çështjet penale dhe atij për çështjet civile. Por edhe ky që jepet për çështjet civile është zakonisht i limituar ose inekzistent. Mund të jetë rregulluar këtë vit. Nuk e di, sepse shifrat janë

të padukshme në materialin që ne kemi marrë, por duhet të jetë në qendër të vëmendjes të parlamentit, meqenëse është hera e parë që ne po diskutojmë për një çështje kaq të rëndësishme.

Unë këtë çështje të padukshme për ndihmën juridike falas nuk e shoh vetëm te Ministria e Drejtësisë, por edhe në shumë ministri të tjera, të cilat mbulojnë probleme të të drejtave të fëmijëve, si dhe të grave. Ju mund të jeni njohur me çështjen e abuzimit, të shfrytëzimit, të trafikimit dhe mosregjistrimit të lindjeve të fëmijëve. Kjo është kategoria më vunerabël që është e padukshme dhe mund të bëhet pre e të gjitha këtyre që unë përmenda.

Ministria e Jashtme është një ministri shumë e rëndësishme. Ne do të donim që në buxhetin që u jepet konsullatave tona jashtë shtetit, të ketë një zë, që, kur ne të kërkojmë dokumente që kanë të bëjnë me fëmijët e lindur jashtë shtetit, të pidentifikuar në Shqipëri dhe që jetojnë në Shqipëri, të kemi një akses të tillë. Në qoftë se sot këto aksesese i siguron shoqëria civile nëpërmjet donatorëve, kjo nuk do të thotë se ky akses do të jetë i përhershëm. Kur u drejtohem konsullatave, pra Ministrisë së Jashtme, na thuhet se ata nuk kanë buxhet të bëjmë komunikimin me postë, me telefon apo me të gjitha llojet e formave për të siguruar dokumentet për fëmijët e pidentifikuar. Mendoj se nuk është ndonjë buxhet shumë i madh. Tingëllon shumë keq kur thuhet: “Mirë, ne ta japim dokumentin, por na dërgo lekët e postës”. Pra, ne, si shoqëri civile, ua dërgojmë lekët atyre, edhe në Angli, edhe në Itali, edhe në Greqi, por kjo nuk ka kuptim, sepse është një buxhet shumë i vogël, që mund të alokohet për këtë qëllim nga Ministria e Jashtme, pra nga zyrat konsullore.

Një sugjerim tjetër është se edhe për ministrinë që kanë të bëjnë me mirëqenien, me shëndetësinë apo me arsimin, duhet të ketë një fond rezervë emergjence për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve, pra për atë kategori që është e përjashtuar, që është e padukshme dhe që nuk i përfiton të drejtat që i takojnë.

Unë ju falënderoj edhe një herë për ftesën dhe ju uroj punë të mbarë për buxhetin e këtij viti!

Vasilika Hysi – Faleminderit, për sugjerimet konkrete!

Po, zonja Shkalla.

Daniela Shkalla – Përshëndetje!

Unë përfaqësoj këtu koalicionin Bashkë Për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve.

Ju falënderoj shumë që konsultoheni me ne dhe që keni krijuar një frymë kaq pozitive në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe me institucione të ndryshme qeveritare!

Unë do të jap disa sugjerime që vijnë nga organizata të ndryshme të koalicionit, duke qenë se ne jemi një koalicion prej 30 organizatash.

Së pari, është financimi i shërbimeve që ofrohen, duke filluar me njësitë e mbrojtjes së fëmijëve. Nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë duhet pasur parasysh që njësitë e mbrojtjes së fëmijëve duhet të kenë një buxhet specifik, jo thjesht vendosja e një personi në pozicion, që ka kaluar nga ndihma ekonomike, në person që punon për mbrojtjen e fëmijëve, por duhet të ketë kapacitetet e duhura, duhet të ketë infrastrukturë që u përshtatet fëmijëve.

Po ashtu, duhet të ketë buxhet për shërbimet e emergjencës, pra të mendohet po nga e njëjta ministri në lidhje me shërbimet e emergjencës. Është e vërtetë që shumë nga këto shërbime, sidomos shërbimet 24-orëshe, janë inekzistente. Kemi vetëm një shërbim që funksionon në Tiranë nga një organizatë e shoqërisë civile. Pra, janë shërbime që ofrohen nga OJF-të. Ndërkohë që në institucionet shtetërore nuk ka një strukturë të tillë ku ne mund të referojmë, pavarësisht se është ngritur pak a shumë sistemi i referimit, duke filluar nga “ALO” apo nga Policia e Shtetit. Sfida më e madhe qëndron ku të dërgohen fëmijët, sidomos fëmijët e dhunuar, të shfrytëzuar apo fëmijët e rrugëve.

Gjithashtu, duhet menduar edhe për financimin e OJF-ve, duke qenë se edhe organizatat që japin shërbime antitrafik, janë më tepër të financuara nga donatorëve të huaj, sepse nuk ka shërbime të mbështetura nga shteti shqiptar.

Po ashtu, kur përmendet buxheti i Ministrisë së Arsimit, duhet pasur parasysh se psikologët e shkollave kanë një rol thelbësor në mbështetjen e fëmijëve në nevojë. Nuk duhet të ekzistojë 1 psikolog për 7 shkolla apo siç ka edhe shkolla që nuk kanë absolutisht psikologë.

Roli i psikologut të shkollës apo edhe në institucionet e paraburgimit apo në institucione ku fëmijët janë në konflikt me ligjin, duhet marrë shumë parasysh, pasi, sidomos për fëmijët që janë në konflikt me ligjin, shpeshherë seancat, intervistat apo komunikimet që bëhen me ta, nuk bëhen në prezencë të psikologëve, pasi nuk ka buxhete që i mbështesin nga institucionet shtetërore, por ofrohen nga shoqëria civile.

Një sugjerim tjetër është ai në lidhje me fondet apo grantet që i jepen pushtetit lokal. Duhet të ketë grante të kushtëzuara, pasi shpeshherë grantet kufizohen në dhënien e ndihmës ekonomike. Kjo nuk është e mjaftueshme, pasi duhet të jetë orientuar në çdo një nga shërbimet sociale, sidomos për fëmijët apo familjet në nevojë. Këtë mund ta bëni shumë mirë duke kushtëzuar përqindjen që shkon specifikisht te fëmijët.

Gjithashtu, në buxhet ishin parashikuar fonde edhe për arsimin profesional. Ky është një moment që lidhet me fëmijët me aftësi të kufizuara, me nevoja të veçanta apo fëmijëve që vijnë nga komuniteti rom dhe nuk kanë arsimin e duhur. Ata duhet të orientohen në këto target-grupe, me qëllim që të kenë mundësi të jetojnë apo të nxjerrin të ardhura.

Po ashtu, në buxhet duhet menduar edhe për shërbimet alternative apo shërbimet e kujdesit alternativ, pra të bëhet e mundur që kjo përqindje të shtohet, duke hequr institucionet rezidenciale dhe të shtohen këto shërbime. Në fakt, këtu lind një pyetje: duke qenë se ministria sapo ka miratuar ndryshimin e moshës nga 16 në 18 vjeç për fëmijët që lenë kujdesin rezidencial, a është menduar një rritje e pagesës për fëmijët që lenë institucionet rezidenciale dhe jetojnë më vetë, pasi edhe vetë fëmijët kërkojnë të ketë një shtesë të pagës që ata marrin apo të shërbimeve mbështetëse?

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Shkalla!

Besoj se një pjesë e çështjeve janë shtruar edhe në Komisionin e Çështjeve Sociale. Zoti ministër na ka dërguar një raport të detajuar të buxhetit dhe ne mund të ndajmë disa nga momentet e rëndësishme, që u japin përgjigje edhe shqetësimeve tuaja. Ndoshta sugjerimi do të ishte për Ministrinë e Financave, që buxhetimin ta bëjnë më të detajuar. Ata i kanë të gjitha, por nuk janë të lexueshme për publikun.

Faleminderit!

Po, zonja Çoku.

Belioza Çoku – Përshëndetje!

Faleminderit edhe një herë për ftesën! Meqenëse përfaqësuesit e shoqërisë civile i thanë pikat më të forta ku ne duam të përqendrohemi dhe shpresojmë që ky proces të gjenerojë me rezultate konkrete për mbështetjen që do të japin me buxhete specifike, sidomos për fëmijët, unë do të ndalem vetëm te shërbimet e emergjencë. Sot, mbi 80 % territorit të Shqipërisë mbulohet me shërbime të emergjencës nga shoqëria civile. Po ashtu, edhe shpërndarja e këtyre shërbimeve i përgjigjet objektivave kryesisht të donatorëve dhe jo një plani strategjik të qeverive që kanë qenë apo edhe qeverisë aktuale, se ku do të shpërndahen këto shërbime apo ku janë fokusuar më shumë nevojat e fëmijëve.

Linja e telefonit për fëmijë, që unë përfaqësoj “ALO 116”, është i vetmi shërbim publik 24 orë që funksionon prej 3 vjetësh, me mbështetjen e UNICEF-it dhe me mbështetjen e

kompanive telefonike që ofrojnë falas thirrjet e telefonave. Tashmë është krijuar një standard. Rekomandimet që vijnë nga Komiteti i të Drejtave të Fëmijëve në Gjenevë dhe nga BE-ja, tregojnë qartë se ka dalë nevoja që ky shërbim jo vetëm të jetë funksional, të jetë i standardizuar, jo vetëm që është i nevojshëm për të ekzistuar, por tashmë janë vetë fëmijët të interesuar, profesionistët, prindërit që e kërkojnë këtë shërbim. Ne nuk mund të kërkojmë pa fund mbështetjen e donatorëve. Është detyrë e qeverisë shqiptare që të mbështesë shërbime të tilla.

E para, janë të nevojshme.

E dyta, sigurojnë të dhëna.

E treta, identifikojnë nevojat që kanë fëmijët sot dhe, mbi të gjitha, tregojnë një nivel dhe një standard të caktuar të avancimit të të drejtave të fëmijëve. Në këtë kuptim, unë do të rekomandoja, meqenëse për shkak të kohës së shkurtër nuk mundëm ta konsultonim në mënyrë specifike propozimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, se çfarë është parashikuar në buxhet për shërbimet e emergjencës, ku linja kombëtare e telefonit për fëmijë “ALO 116-ta”, është mbështetur edhe nga rekomandimet e institucioneve më të larta ndërkombëtare, të cilat kanë parë se është i vetmi shërbim që i përgjigjet drejtpërdrejt interesit më të lartë të fëmijëve.

Rekomandimi dhe sugjerimi për të cilin do të këmbëngulja më shumë është një buxhet specifik ose përgjigje specifike se çfarë parashikon Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, e mbështetur edhe nga Ministria e Financave, për sa i përket shpërndarjes së shërbimeve të emergjencës. Cili është niveli i buxhetit që do të mbështesë këto shërbime dhe konkretisht linjën e telefonit për fëmijët “ALO 116-ta”?

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Çoku!

Po, zoti Hazizaj.

Altin Hazizaj - Faleminderit, zonja Hysi!

Pa dashur të kaloj në përsëritje, sepse shumica e kolegëve folën dhe i prekën gjërat, unë dua të flas për një çështje perceptimi. Në fakt, duke parë buxhetin në përgjithësi, për sa i përket çështjes së minoritetin rom, nuk është menduar një qasje e integruar. Konkretisht, ministritë e linjës, siç është Ministria e Mirëqenies, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Zhvillimit Urban, nuk kanë alokuar fonde të veçanta për të ulur varfërinë e këtij komuniteti.

Dua të sjell në vëmendjen tuaj muajin gusht të këtij viti, kur 37 familje rome u përdoqën nga trualli i pronarit këtu në Tiranë dhe u endën për muaj të tërë për t'u strehuar. Në kuadër të

kësaj, do të sugjeroja qartësimin e buxhetit të Ministrisë së Zhvillimit Urban, posaçërisht për minoritetin rom. Nga kërkimet që ne kemi bërë në terren, një shqetësim shumë i rëndësishëm i komunitetit rom është edhe punësimi. Do të doja që Ministria e Mirëqenies të qartësojë se sa do të jetë buxheti që do të investohet për punësimin e minoritetit rom. Deri më sot punësimi i komunitetit romë është parë si sipërmarrje, por sipërmarrja nuk mund të zgjidhë punësimin e këtij minoriteti.

Kam edhe një pyetje për Ministrinë e Financave, sepse kam 24 orë që mundohem të kuptojë buxhetin dhe ta përkthejë në gjërat që janë bërë. Te “shpenzime kapitale të kushtëzuara”, u referohen investimeve që janë bërë apo atyre që do të bëhen?

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Unë kam besim se zoti Opre po i mban shënim të gjitha pyetjet dhe paqartësitë tuaja. Po ashtu, edhe ne do t’i detajojmë një për një. Ju falënderoj që po i ndani sipas ministrive të linjave, që ne t’i zbardhim menjëherë për t’ia çuar ministrive, komisionit dhe për t’i pasur parasysht te linjat e ministrive përkatëse!

Ju falënderoj për prezantimin e saktë, të shkurtër dhe konkret që bëtë në lidhje me projektbuxhetin!

Vazhdojmë me pyetjet. Pastaj do t’u japim fjalën përfaqësuesve të Ministrisë së Financave, për të mbyllur pjesën e të drejtave të fëmijëve.

Po, zoti Ristani.

Arben Ristani – Vërtet që buxheti ka ardhur në një kohë të shkurtër për konsultime jo vetëm për ju, por për të gjithë ne. Megjithatë, e gjithë përpjekja për ta zbërthyer atë dhe për të dhënë ndihmesë, është për t’u falënderuar.

Në konsultimin që patëm me ministrin e Brendshëm, unë për herë të parë po dëgjoja që nënave që lindin, u jepen 5000 lekë dhe që nuk qenka dhënë. Mua nuk më duket i drejtë arsyetimi që, meqenëse nuk është dhënë, të mos jepet më. Nuk më duket i drejtë arsyetimi se është akumuluar borxh, sepse nuk është akumuluar borxh. E drejta që jepet në ligj është një e drejtë që duhet kërkuar dhe po nuk u kërkua brenda një afati kohor, parashkruhet, kështu që nuk është e vërtetë që ka borxh për këtë çështje. Ajo është një e drejtë, të cilën po nuk e kërkoje, kalon.

Megjithatë, e lëmë pjesën e historisë së borxhit. Për mua edhe sikur të jetë, është diçka e pathënë. Në rast se do t'i shkojmë arsyetimit se, meqenëse nuk është dhënë, të mos jepet më, nuk besoj se zgjidhim gjë. Kjo nuk mund të jetë filozofi për çdo gjë në kërkesat tuaja. Për mua kjo është mënyrë të vepruari dhe të menduari. Kur mendohet kështu për këta 5000 lekë, besoj se edhe për shumë nga kërkesat do të mendohet në këtë formë. Prandaj, të mos mendohet në këtë formë, por kërkesat që janë të drejta të gjejnë rrugën e zgjidhjes dhe të zbatohen.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Altin Hazizaj – Për sa i përket çështjes së fëmijëve me AIDS, më falni që nuk e ngrita më parë këtë çështje, një pjesë e ilaçeve të tyre nuk janë financuar nga buxheti i shtetit. Ato duhet të financohen nga buxheti i shtetit dhe jo vetëm ilaçet, por duhet të marrin një paketë të plotë ushqimore për mirëqenien e tyre.

Vasilika Hysi – Faleminderit për ndërhyrjen për mbrojtjen e fëmijëve me AIDS!

A ka ndonjë përfaqësues nga fshati SOS, meqenëse i kemi ftuar për fëmijët jetimë? Dakord. Faleminderit!

Fjala për ju, zoti Opre.

Gentian Opre – Faleminderit!

Përpara se t'u përgjigjem pyetjeve specifike, do të doja të bëja një sqarim lidhur me buxhetimin, pra me formën e buxhetimit që sillet në parlament. Përveç buxhetit vjetor, që vjen në parlament çdo vit ekziston edhe një buxhet tjetër afatmesëm, pra programi buxhetor afatmesëm. Ky dokument përgatitet nga ministritë e linjës dhe nga Ministria e Financave që në muajin shkurt të vitit parabuxhetor. Kjo do të thotë që ju vetë keni në dispozicion gjithë kohën për t'u konsultuar me ministritë e linjës që ju interesojnë për çështjet që mbuloni, që prej muajit shkurt deri në fund të shtatorit. Për t'ju lidhur më shumë me influencën që ju do të ushtroni në çështjet specifike që mbuloni, Ministria e Financave me ministritë e linjës, për llogari të programit buxhetor afatmesëm zhvillon seanca dëgjimore në muajin maj dhe shtator. Pra, alokohet për çdo ministri një datë dhe një kohë e caktuar, në të cilën ballafaqohen kërkesat e tyre buxhetore me mundësitë buxhetore të Ministrisë së Financave.

Vetë programi buxhetor afatmesëm, për të adresuar edhe shqetësimin se ku janë aktivitetet specifike, ku janë fondet për çdo aktivitet apo për çdo objekt që ka një ministri linje ose një program specifik, ka disa programe që alokohen në buxhet për ministri të caktuara. Këto

programe zërthehen më tej në programin buxhetor afatmesëm me qëllime, objektiva, produkte dhe aktivitete të cilat marrin këtë kosto.

Programi buxhetor afatmesëm është një dokument i gjerë, diku te 800 apo 1000 faqe, ku ju mund të shikoni çdo detaji të planifikuar për buxhetet e secilit program shpenzimi të çdo ministrie. Në të mund të gjeni ose jo, dhe në momentin që nuk gjeni, mund të ushtroni presionin tuaj për të adresuar çështjet që ju shqetësojnë.

Unë ju ftoj që në këtë ushtrim, që fillon në muajin shkurt, por edhe më herët, të jeni aktiv, qoftë me ministrinë e linjës, qoftë me ekipet e menaxhimit të programit, për programet specifike që ju jeni të lidhur, qoftë me ne, për të qenë pjesë aktive në seancat dëgjimore që ne zhvillojmë me këto ministri linje dhe me programet në veçanti, në mënyrë që të reflektohen sa më shumë këto prioritete dhe aktivitete.

Në muajin janar, ne do të publikojmë planin buxhetor afatmesëm 2014-2016, i cili do të marrë parasysh reflektimet e shifrave të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2014. Ky dokument do t'ju shërbejë si pikënisje për të evidentuar aktivitetet që ju duhet të ndiqni për vitin 2014 dhe në vazhdim. Për çdo mangësi do të punoni bashkë me ne, si pjesë e këtij procesi, për t'i adresuar në periudhën në vijim, duke qenë se fillon edhe përgatitja e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017, pra gjatë vitit 2014. Besoj se koha për të bërë adresimin e të gjitha çështjeve që mbulojnë buxhetin për fëmijët dhe për buxhetin gjinor, është e mjaftueshme.

Gjithashtu, ju informoj se është në fuqi një vendim i Këshillit të Ministrave për sa i përket buxhetimit gjinor. Ka filluar targetimi i tij në 2 ministri, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe në Ministrinë e Bujqësisë. Për 2 programe specifike do të identifikohet një objektiv gjinor, i cili më pas do të prodhojë edhe akutet të cilat kanë sfond gjinor. Synimi është që në programin buxhetor afatmesëm 2015-2017, kjo të shtrihet në sfera të tjera që prekin këtë fushë dhe të targetohet edhe për çështje që kanë të bëjnë me fëmijët. Mund të them se është më shumë problem ligjor sesa problem ushtrimi, që, normalisht duhet të bëhet nxitja e duhur për t'i pasur këto aktivitete apo këto kosto në programin buxhetor afatmesëm, si dhe në buxhetin vjetor. Ndërkohë, i lihet shumë kohë edhe monitorimit, sepse ka shumë rëndësi që ajo që planifikohet në letër, të monitorohet më vonë dhe të raportohet, në mënyrë që të shikohet se sa po zbatohet në praktikë ajo që planifikohet në buxhet.

Për sa i përket pyetjes që ka të bëjë me fondet për mbështetjen e shoqërisë civile, do të thosha se është Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile, e cila për këtë vit ka alokuar fondin

prej 100 milionë lekësh. Ndoshta detajet i jep një tabelë tjetër, jo tabela përmbledhëse e atij institucioni, por ju siguroj se ky fond është në këtë vlerë. Është me rritje të lehtë, por janë 100 milionë të alokuar për këtë vit, që më pas është subjekti i një procesi konkurrimi për të përfituar nga ky fond sipas kuadrit ligjor në fuqi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse shihni tabelën 5, është 100 milionë. Është tek artikulli 604, pra për transfertat që i dedikohen entiteteve të tjera jashtë qeverisë.

Për sa u përket pyetjeve të tjera, unë i ezaurova me shpjegimin që bëra për programin buxhetor afatmesëm.

Për sa u përket fondeve buxhetore specifike që janë kërkuar përtej tavaneve që janë alokuar për ministrinë përkatëse, kërkesat mund të vijnë nëpërmjet Komisionit të Ekonomisë. Ato do të shqyrtohen nga ana jonë. Duhet të kihet parasysh se ka edhe kufizime buxhetore.

Po ashtu, dua t'ju inkurajoj që të bëhet presioni i duhur, në mënyrë që aktivitetit të buxhetohen aq sa mundet, në mënyrë që të planifikohen, të monitorohen, të raportohen dhe më pas të identifikohet edhe performanca e tyre në kohë.

Për çështjet që kishin të bënin me Ministrinë e Arsimit lidhur me buxhetimin 5%, mund t'ju them se fondi për arsimin në total, duke përfshirë edhe elemente të tjera që kanë të bëjnë me arsimin, por që nuk i përkasin Ministrisë së Arsimit dhe sportit, për vitin 2014 parashikohet që fondi të shkojë në rreth 3,4 % të produktit të brendshëm bruto.

Objektivi i qeverisë është që në vitin 2017, që është edhe viti i fundit i mandatit, fondi të arrijë në 5%, kështu që shuma për këtë ministri do të rritet. Për të dhënë më shumë detaje për Ministrinë e Arsimit, do të flasim kolegët e mi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Opre!

Në fakt, ju falënderoj për transparencën dhe për informacionin që ndatë me përfaqësues të shoqërisë civile dhe i ftoj ata të bëhen pjesë e debatit që në muajin janar të vitit 2014!

Unë do të ftoja përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit dhe të Sporteve të japin përgjigje shumë shkurt për pyetjet që lidhen me arsimin.

Po, zoti Mazniku.

Arbër Mazniku – Përshëndetje!

Ju falënderoj për ftesën dhe për mundësinë që të shpjegojmë planet buxhetore për këtë vit! Ky do të jetë një vit i vështirë buxhetor, ku një pjesë e madhe e buxhetit ka shkuar për atë që quhet “larja e borxheve të prapambetura”.

Ne jemi të kënaqur për faktin që ndër ato pak ministri, që kanë një rritje në krahasim me peshën që buxheti ka në raport me prodhimin e brendshëm bruto, është edhe Ministria e Arsimit. Madje, ndoshta është ministria me rritjen e dytë më të madhe.

Pra, funksioni i parë me rritjen më të madhe është ai i mbrojtjes sociale, që tipikisht në një vit të vështirë është e kuptueshme që të ketë rritjen më të madhe, në një situatë të vështirë ekonomike. Kurse zëri i dytë që ka peshën më të madhe të rritjes, është funksioni buxhetor i arsimit brenda parametrave të mundshëm. Pa dyshim, nuk është një buxhet i cili do të përmbushë ambiciet dhe planet tona, duke pasur parasysh edhe situatën ekonomike. Sidoqoftë, ne mund të arrijmë një pjesë të madhe të objektivave të vendosura për këtë vit, veçanërisht në çështjen e mbrojtjes së fëmijëve në arsim. Ne kemi disa objektiva që do t'i arrijmë nëpërmjet buxhetit të vitit që vjen.

Po jap 2-3 të dhëna të përgjithshme:

Funksioni i arsimit në total, me të gjithë zërat e tjerë, shkon në rreth 3,4% e GDP-së e prodhimit të brendshëm bruto. Ky është një hap i qëndrueshëm drejt synimit për ta çuar në rreth 5% brenda këtij mandati qeverisës. Në vetvete, ky funksion zë rreth 11% të të gjithë buxhetit të qeverisë, që po ashtu është një rritje e qëndrueshme.

Arsimi parauniversitar zë rreth 85,3% të buxhetit të Ministrisë së Arsimit ose rreth 7,45% të shpenzimeve të buxhetit apo 2,5% të prodhimit të brendshëm bruto. Kjo do të thotë se pjesa më e madhe e shpenzimeve buxhetore shkon për të mbështetur arsimin parauniversitar.

Gjithashtu, siç dhe është lajmëruar nga Ministria e Financave dhe nga Kryeministri, gjatë këtij vit nuk do të ketë investime kapitale të reja, por në të gjitha linjat e ministrive do të vazhdohen investimet ose kontratat e nisura, me përjashtim të Ministrisë së Arsimit, ku ne synojmë të ndërhyjmë rreth 150 ndërtesa të reja shkollore në të gjithë vendin, duke kombinuar paratë që janë alokuar, pra rreth 3,4 miliardë lekë për investime kapitale në arsim, plus rreth 2,55 miliardë lekë që janë borxhe të prapambetura, të cilat shkojnë në rreth 7 miliardë lekë investime kapitale në arsim. Ne besojmë se ky është një buxhet i qenësishëm brenda kuadrit të problemeve që ka buxheti.

Në ministri është debatuar gjatë çështja e hapjes së një zëri të veçantë buxhetor për arsimin parashkollor. Është një proces për të cilin duhet pak kohë, sepse duhet bërë paralelisht edhe në planin buxhetor afatmesëm. Ne jemi në diskutim me Ministrinë e Financave për të parë mundësinë që një gjë e tillë të bëhet gjatë vitit që vjen, duke u reflektuar në planin afatmesëm dhe, eventualisht, edhe në një buxhet të ardhshëm. Duke qenë se ka nevojë për shumë peripecira teknike në thesar, në Ministrinë e Financave, në planifikimet afatmesme, në tentativën për të bërë krahasimet, shkojnë prapa në kohë. Nuk është një çështje teknikisht aq e thjeshtë sa ç' duket, sepse me aq sa dëgjova, mendova se mund të ishte diçka që ndahet në pjesë buxheti. Në fakt, kjo është një çështje më e komplikuar se kaq, por është një pjesë e vogël e nevojës që ne kemi për të pasur një fokus më të madh, veçanërisht në arsimin parashkollor, i cili është caktuar dhe si tri prioritetet e Ministrisë së Arsimit gjatë 4 vjetëve të ardhshëm.

Për sa u përket kategorive në nevojë, unë e mirëkuptoj kërkesën për të pasur bursa studimore për to, veçanërisht për fëmijët romë, egjiptianë dhe grupe të tjera të marginalizuara në sistemin parauniversitar. Ne po tentojmë për ta zgjidhur këtë si problem. Në thelb kapaciteti ynë për të dhënë bursa në atë nivel është i limituar, sepse tipikisht pjesa e trajtimit me bursa aty trajtohet kryesisht nga pushtetet lokale dhe ne jemi duke tentuar të ndihmojmë dhe të gjejmë mekanizma nëpërmjet pushtetit lokal dhe shërbimeve sociale që të lehtësojmë aksesin më të madh të këtyre grupeve shoqërore në arsim.

Një ndër reformat tona të mëdha të këtij viti dhe që është një risi, që do të lehtësojë këtë çështje, është ajo që ne kemi linçuar, shkollat si qendra komunitare, që është një mekanizëm me të cilin ne synojmë që të thërrasim në shkollë, jo vetëm gjatë orarit të mësimit, por dhe përtej, fëmijët dhe të rinjtë e komunitetit për t'u dhënë shanse të vazhdueshme për t'u arsimuar, por edhe për të pasur mundësi socializimi me njëri-tjetrin përtej shkollës.

Nga ana tjetër bursat për arsimin e lartë për komunitetin rom, egjiptian dhe grupet e tjera të marginalizuara vazhdojnë të kenë një zë të rëndësishëm brenda buxhetit dhe ne do të vazhdojmë t'i japim ato gjatë vitit që vjen, duke përmirësuar në mënyrë madhore mekanizmin me cilin ato janë dhënë sepse ka pasur mjaftueshëm probleme sivjet.

Një gjë tjetër që nuk u përmend, por unë besoj se është e rëndësishme ta themi, është që kemi rritur në mënyrë të qëndrueshme fondin e transportit të fëmijëve drejt shkollave duke pasur parasysh që ka qenë një çështje problematike. Dhe pjesë e këtij procesi do të jetë nevoja për të riakomoduar transportin e fëmijëve që jetojnë larg shkollave. Gjithashtu, si rrjedhojë e

ndryshimit të akcizës së naftës, mund të ketë nevojë për një rialokim të fondeve për transport, në mënyrë që të paktën në këtë aspekt të mos ketë asnjë lloj pengese.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Mazniku!

Po, zoti Nuri.

Florian Nuri - Faleminderit!

Për të sqaruar më në detaje, unë, në vijim të fjalëve të zëvendësministrit, zoti Mazniku, do të shtoja që çështja e ngritjes së një programi të ri buxhetor për arsimin parashkollor nuk është një çështje thjeshtë teknike, por kërkon burime menaxheriale në të gjithë sistemin e thesarit, kërkon burime menaxherimi ose personel në Ministrinë e Arsimit. Në kuadër të ristrukturimit numri i punonjësve është ulur, sepse nuk është vetëm t'i japësh buxhet 3 miliardë ose 4 miliardë, por buxheti do monitoruar që të shkojë atje ku buxhetohet, atje ku ka prioritete, atje ku përcaktohen objektiva, atje ku duhet ta masësh me standarde pse u krijua dhe çfarë u arrit. A solli të mira, apo solli vetëm një shpërndarje empirike? Ne kemi pasur mbështetje edhe nga UNICEF-i.

Së pari, çështja është e shtimit të kapaciteteve nga Ministria e Financave, e shtimit të kapaciteteve njerëzore dhe e pajisjeve në Ministrinë e Arsimit dhe në Ministrinë e Financave.

Së dyti, ne, pavarësisht se nuk e kemi program buxhetor për ta monitoruar me sistem thesari më vete, e kemi më vete, e buxhetojmë më vete. Ai sot zë gati 10% të arsimit bazë, punojnë deri në 5 mijë e 500 punonjës, janë 74 mijë deri në 76 mijë fëmijë në parashkollor dhe synimet janë të përshkruara në strategjinë e arsimit parauniversitar. Pra, çdo objektivi është qartësisht i monitoruar, për fëmijët e secilës grup-moshë.

Së treti, megjithëse buxheti i shtetit në relacion nuk jep të detajuara se çfarë shkon te arsimit, ju mund ta gjeni në faqen e Ministrisë së Arsimit, në faqen e Ministrisë së Financave relacione të buxheteve, raporte monitorimi, të cilat kanë të përshkruara objektivat, arritjet dhe çfarë ka shkuar në vite. Në buxhetin e arsimit 3 mijë e 830 romë për 3 vjetët e fundit kanë përfituar tekste falas, mesatarisht 40 deri në 50 dollarë për çdo nxënës.

Për bursat e fëmijëve. Për të gjithë parauniversitarët dhe fëmijët që ndjekin arsimin profesional, për shtresat sociale në nevojë, ne japim rreth 4 mijë e 500 bursa në vit me një kosto mesatare vjetore prej 1,8 milionë dollarë. Ne japim tekste shkollore falas në bazë të vendimit të qeverisë për rreth 120 mijë fëmijë. Mund t'i gjeni listat në çdo njësi arsimore në ministri, të detajuara për çdo program, për çdo shkollë, për çdo fshat, për çdo njësi të qeverisjes vendore.

Kostoja mesatare vjetore në 3 vjetët e fundit ka shkuar, deri në 3,5 milionë dollarë. Në vitin 2013 ishte 3,2 milionë dollarë. Ne financojmë bursa në arsimin e lartë për 8 mijë studentë, 4,1 milionë dollarë deri në 4,3 milionë dollarë. Ne financojmë për studentët ekselentë, që ndjekin universitetet më të mira të botës ose 15 universitetet më të mira të botës, 1,5 milionë dollarë. Për arsimin parauniversitar, për transportin e rreth 30 mijë nxënësve financojmë rreth 6 milionë dollarë. Në total vetëm për shtresat sociale në nevojë ne financojmë, si mbështetje për të ulur varfërinë, për të ndjekur shërbimin arsimor, për t'u sjellë familjeve më afër arsimin, ose për ta çuar arsimin atje ku jetojnë qytetarët ose fshatarët, rreth 17 milionë dollarë. Buxheti i arsimit, po të shihni tabelën 5, është shumë i detajuar, dhe po të shihni artikujt, do të kuptoni që është buxhet shumë social. Nga grupi i shpenzimeve korrente 70% është mbështetje sociale, e para.

E dyta, për romët ne kemi bërë një shkollë pilot së bashku me UNICEF-in, kemi bërë shkollën "Naim Frashëri" në Korçë. Për financimin e ushqimit, kuotë ushqimore me 75 lekë në ditë duhet të ushqehen në shkollë, në shërbimin e llojit catering, rreth 320 nxënës ose 312 sa janë sivjet. Meqenëse ka pasur kapacitete të ulëta, ia kemi kaluar njësisë së qeverisjes vendore, Bashkia Korçë, e cila i ka listat, i identifikon cilët janë romë, cilët jo dhe kjo është pilotuar. Këto ishin kërkesat. Nëse kanë kërkesa për më shumë, më të detajuara, ku duhet të arrijmë, unë po ju them se këto janë arritur dhe këto janë buxhetuar edhe për vitin 2014. Nëse keni kërkesa më specifike, përfaqësuesi i Ministrisë së Financave ju ofroi që në fillim të marsit ju mund të sillni propozimet tuaja në Ministrinë e Arsimit. Adresojini qartësisht kërkesat tuaja për t'u marrë parasysh në buxhetimin e viteve 2015-2018.

Kastriot Islami – Unë dua të shtoj diçka. Duke ju falënderuar për gjithçka që thatë, duhet të kemi parasysh dy gjëra: rastin e fëmijëve dhe të grave. Po të kishte mundësi, por nuk besoj se do të ketë mundësi, se koha në dispozicion është shumë e shkurtër, të jepen përgjigje për kërkesat që kanë këta. Çfarë mund të bëhet në buxhetin e vitit 2014? Në qoftë se nuk ka mundësi, mekanizmi që dhatë ju është mekanizmi i konsultimit nëpërmjet buxhetit 3-vjeçar afatmesëm, ku këta mund të përfshiheshin gjatë hartimit të strategjisë kombëtare të zhvillimit dhe integritit. Por gjëja që presin këto kategori është që çdo vit, kur ministrinë fillojnë të bëjnë caktime të tavanëve për diskutime të projekteve, të thirren dhe të konsultohen, sepse buxheti afat-mesëm dihet se si funksionon, por kur fillon viti tjetër ato ndryshojnë dhe kërkesat që kanë të ngelen në fund. Në përgjithësi kështu ndodh, ka pak para dhe kërkesat e OJQ-ve ngelen në fund. E para.

E dyta, doja të korrigoja një gjë. Ky buxhet është e vërtetë që ka probleme, por ka probleme me dy gjëra. Ka në paketën fiskale dhe në deficit, por të ardhurat i ka të larta, një shumë prej 455 miliardë lekë. Nga 455 miliardë lekë po të heqim 35 miliardë, që shkojnë për detyrimet, ngelen 420 miliardë. Pra, është 20 miliardë më i madh sesa i vitit 2013. Në qoftë se ju nga 455 miliardë kërkon 100 mijë ose 200 mijë, kjo është një shifër shumë e madhe. Po të ketë vullnet dhe një mekanizëm konsultimi, është një shifër që mund merret në konsideratë. Ju bëni kërkesat tuaja, ne po i mbajmë shënim këtë vit dhe do të shikojmë më pas. Unë nuk kam besim se do të bëhet gjë këtë herë, sepse buxheti është shumë i shtrënguar, pavarësisht se mund t'ju themi fjalë të bukura këtu, por të paktën t'i mbajmë shënim, që të jetë një trampolinë e mirë për vitin tjetër. Kjo trampolinë duhet të fillojë që nga ministrinë e linjës në konsultimet që duhet të bëjnë me të gjithë ju gjatë kohës që fillon diskutimi i buxhetit nëpërmjet Ministrisë së Financave me ministrinë e linjës. Ne po e mbajmë shënim këtë. Kjo është një pikë fillestare, por të keni parasysh praktikën që është në vendin tonë, në përgjithësi çfarë vendos qeveria, atë vendos maxhoranca, derisa e vendosin ministrat dhe është shumë vështirë pastaj që gjërat të ndryshojnë. Megjithatë ne do të bëjmë maksimumin për të përcjellë zërin tuaj ku duhet, por qëllimi është që të arrihet diçka.

Faleminderit!

Mimoza Hafizi - Faleminderit!

Desha t'ua jap fjalën përfaqësuesve të shoqatave të grave. Meqenëse koha është shumë e shkurtër, keni vetëm 2 minuta kohë.

Fjalën e ka Iris Luarasi.

Iris Luarasi – Faleminderit!

Ne pas pak organizojmë një event për gratë e dhunuara, u kemi mbledhur disa lodra fëmijëve, kështu do të nisemi për atje. Ndërkohë ju kërkoj dhe ndjesë që do të largohem pasi të mbaroj së foluri.

Mendoj se jemi në të njëjtat linja dhe me prezantimet që u bënë këtu nga përfaqësuesit e organizatave të fëmijëve. Në fillim të kësaj jave është mbajtur edhe një konferencë shumë e madhe e sektorit të shoqërisë civile me qeverinë shqiptare, madje është firmosur dhe një marrëveshje. Në fakt unë nuk e shikoj nga pikëpamja e buxhetit këtë gjë, sepse ajo që kemi kërkuar si sektor prej shumë vitesh është pjesa e subkontraktimit të NGO-ve nga qeveria, që mund të kryhet nëpërmjet Agjencisë së Shoqërisë Civile dhe sigurisht jo vetëm nëpërmjet kësaj

agjencie, por dhe nëpërmjet të gjitha ministrive të linjës që afektojnë shërbimet që ne i japim publikut në mënyra specifike. Në të gjithë Europën 40% deri në 70% të gjitha shërbimeve publike qeveria ia kontraktton komunitetit të shoqërisë civile me pjesën e komplimentimit të shërbimeve, sepse në asnjë vend nuk ndodh që qeveria të kryejë të gjitha shërbimet. Dhe në Shqipëri kemi absolutisht shërbime që nuk administrohen dot nga qeveria, por që sektori është gjithmonë aty i gatshëm dhe deri tani ka pasur shtresa në nevojë, të cilat janë mbështetur kryesisht nga sektori i shoqërisë civile.

E para, përveç pjesës së buxhetit do të donim që të shikonim dhe një buxhet për sa i përket ligjit të subkontraktiveve të shërbimeve sociale, sepse kjo është një nga gjërat e para që neve na intereson.

E dyta, ka lidhje me aksesin e shërbimit ligjor falas për viktimat e dhunës në familje dhe Dhe pjesa e tretë ka lidhje me linjën kombëtare kundër dhunës, sepse është një gjë që ka munguar, është kërkuar prej kohësh dhe sigurisht që kjo nuk mund të jetë prapë një gjë siç ndodhi me strehën shtetërore për viktimat e dhunës në familje, por duhet të jetë një shërbim i cili i jepet organizatave që kanë eksperiencë në këtë gjë. Deri tani kemi vetëm një funksion që mund të subkontrakttojë organizatat e shoqërisë civile, që është ligji i prokurimit publik i cili ka një problem jashtëzakonisht shumë të madh në subkontraktimin e NGO-ve.

Ka disa përpjekje nga qeveria lokale për ta realizuar këtë gjë. Përpjekja më e suksesshme ka qenë në Bashkinë e Shkodrës, por në fund fare dhe ajo rezultoi një përpjekje që u kap si shkelje nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, kështu që ligji është absolutisht i paqartë, mungon kjo pjesa e ligjit dhe ne do të donim në mënyrë të jashtëzakonshme ta shikonim brenda buxhetit subkontraktimin e NGO-ve, sepse kjo është “thembra e Akilit”, mendoj unë, për të gjitha shërbimet tona. Pastaj janë pjesë të tjera ligjore, por meqë jemi te komisioni që nuk janë lidhje aq shumë me pjesën e buxhetit, por që kanë lidhje me pjesën e ligjit, që, nga pikëpamja ligjore pa diskutim duhet të ndryshojë edhe pjesa e prokurimit publik, për sa i përket subkontraktimit të organizatave të shoqërisë civile duke hequr dhe pjesën e 5%-shit, sepse shumica e NGO-ve nuk kanë mundësi financiare që depozitojnë 5% të shumës së një tenderimi në momentin që fillon procesi i tenderimit, por edhe të gjitha kërkesat burokratike që i penalizojnë me rreth 70% deri 80% të NGO-ve për të mos hyrë pjesë në një prokurim publik.

Mimoza Hafizi – Faleminderit, zonja Luarasi!

Problemi i ligjit të subkontraktimeve doli edhe nga shoqatat e fëmijëve dhe besoj se do të jetë një nga objektivat dhe iniciativë e Aleancës së Grave.

Po, Mirela.

Mirela Arqimandriti – Jam Mirela Arqimandriti nga qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim. Unë doja të merrja shkas pak nga fjala e zotit Ohri në lidhje me buxhetin e shtetit, në lidhje me konsultimet, me shoqërinë civile të cilat me thënë të drejtën vitet e fundit kanë munguar totalisht. Gjithashtu, dua të diskutoj në lidhje me dokumentet që ne kishim bashkëlidhur me ftesën që ne kemi marrë dhe me thënë të vërtetën të gjitha dokumentet nuk janë fare të përfaqësuar nga pikëpamja gjinore. Aty mungon totalisht një analizë gjinore, që mund të na japë mundësinë të japim dhe mendimet tona. Kështu që unë kam nxjerrë disa gjëra.

Këtu përpara kam buxhetin e shtetit. Në fakt kam pyetje, por rekomandime, pasi, sipas mendimit tim, këtu mungojnë absolutisht të gjitha gjërat që ne kemi ngritur gjatë viteve, sidomos gjatë vitit të fundit në lidhje me çështjet gjinore në grupe të ndryshme parlamentare. Ne kërkojmë që vitin tjetër, meqenëse shkurti është shumë afër, të përfshihemi në këto lloj diskutimesh, dhe, gjithashtu, të bëjmë së bashku ushtrimin e buxhetimit gjinor i cili pretendohet se funksionon, por në fakt nuk funksionon fare.

Unë jam tani te Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Ka 41% të buxhetit në dispozicion të kësaj ministrie për zhvillimin rural duke mbështetur prodhimin bujqësor blegtoral, agro-industrial. Ndërkohë dua të di se sa përqindje kanë këtu gratë në zonat rurale? Çfarë do të marrin gratë në zonat rurale nga ky buxhet, që është 41% e totalit që Ministria e Bujqësisë ka në dispozicion? Te Ministria e Shëndetësisë rreth 89% janë për shërbimet e kujdesit parësor dhe kujdesit dytësor dhe këtu ne kemi shumë probleme me shëndetin e grave, kemi probleme me kancerin e gjirit, kemi probleme me kancerin e mitrës, kemi probleme me kujdesin shëndetësor në zonat e thella malore. Pra, si është adresuar kjo gjë në buxhetin e shtetit? Këtu shifrat janë në total dhe më vjen keq që unë nuk kam asnjë lloj informacioni në lidhje me këtë gjë, megjithëse e kemi ngritur disa herë. Në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë kemi 65% të buxhetit ku thotë sigurimi shoqëror. Unë nuk e kuptoj dhe dua sqarime në lidhje me këtë.

Gjithashtu, vura re të gjitha tabelat që janë në dispozicion, buxhetet për bashkitë, por janë shumë pak në lidhje me hallet e mëdha që ka çdo bashki, sidomos në zonat e thella malore ku kemi probleme të shumta, pavarësisht shifrave që ju dhatë, që keni bërë për fëmijët dhe ndihmën

që ju u keni dhënë atyre. Por dhe gratë kanë nevojë të jashtëzakonshme për buxhete pranë bashkive, sidomos për funksionimin ashtu siç duhet të mekanizmit kundër dhunës në familje, kundër trafikimit, pasi mosparaqitja ashtu siç duhet në buxhetin e shtetit dhe këtyre lloj problemesh sjell të gjitha problemet e tjera sociale që ne na vijnë më pas. Pra, buxheti i bashkive është shumë pak, nuk është krahasues.

Unë kam, gjithashtu, dhe një gjë konkrete në lidhje me strategjinë antikorruption dhe këtë e kam të lidhur direkt me bizneset e vogla që përbëjnë 98% të të gjithë punësimit ose edhe me të ardhurat që vijnë nga bizneset në Shqipëri. Me sa dimë, bizneset kanë shumë probleme. Bizneset nuk regjistrojnë. Pra, sistemi fiskal është i dështuar në momentin që bizneset nuk regjistrojnë në kasat e tyre fiskale, por kjo nuk vjen sepse bizneset nuk duan të regjistrojnë, kjo vjen për arsye se tavanit që tani është rritur dhe është bërë 8 milionë është përsëri shumë pak dhe u sjell atyre probleme, të cilat lidhen me shumë institucione që i mbikëqyrin, probleme të ndryshme korrupsioni. Rreth 26% e grave që drejtojnë bizneset, në bisedat që ne kemi bërë në tryeza të ndryshme të rrumbullakëta me to, ato kërkojnë që kjo shifër të shkojë në 10 milionë, në mënyrë që të kenë mundësi të regjistrojnë gjithçka dhe të mos jenë pre e një kontrolli të menjëhershëm tatimor, i cili vjen dhe gjen pa prerë për shembull një faturë kase në një floktore ose në një bar-kafe. Kjo, në radhë të parë, afekton dhe gratë që janë aty të punësuar në biznes. Çdo gjë që merr biznesi për shkak të mosprerjes së një fature të vogël për shembull 100 – lekëshe, kuptohet është 1 milion të vjetra, 2 milionë dhe sjell menjëherë nxjerrjen jashtë tregut të punës të një ose dy punonjësve dhe kryesisht këto janë gra.

Faleminderit!

Mimoza Hafizi - Faleminderit!

Për ata zëra që ju mendoni se janë të pa sqaruar mbase na lënë fleksibilitetin që të rregullohen në proces, megjithëse duhet të na e thotë Ministria e Financave, në qoftë se keni liri për t'i përcaktuar.

Gentian Opre – Për sa u përket zërave, normalisht që ato nuk janë aty, por janë në dokumentin e programeve buxhetore. Gjithsesi, Ministria e Bujqësisë dhe ministritë e tjera të interesuara në prezantimet e tyre mund të ishin prezent dhe t'i adresonin këto çështje. Besoj se ka numër të saktë në janar kur të bëhet drafti final i programit buxhetor afatmesëm dhe mund të keni një numër të qartë.

Për sa i përket buxhetimit gjinor jua thashë që jemi në një grup pune të “You and Woman” me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për ta zgjeruar komplet skemën lidhur me buxhetimin gjinor dhe më pas me monitorimin dhe raportimin.

Për sa i përket çështjes së kasave fiskale ose më saktë atij limiti 8 milionë, unë nuk jam në gjendje tani të them se mund të ndryshojë ose jo, por besoj se do të jetë dhe kjo pjesë e procesit të diskutimeve në bashkëpunim me strukturat përkatëse në Ministrinë e Financave, për sa u përket politikave fiskale, për të diskutuar shtimin ose jo të kësaj steke, të këtij limiti, për sa i përket të qenit biznes i vogël ose i madh, për efekt të taksimit më pas nga sistemi tatimor. Ju mund të jeni pjesë aktive në mënyrë që të jepni dhe ju argumentet tuaja sepse është e nevojshme për të arritur këtë shumë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Opre!

Unë doja t’ju vijja në dijeni, sepse ministri i Shëndetësisë ka dhënë një informacion të detajuar me shkrim. Për vitin 2014 do të vihet në funksion akselatori për parandalimin dhe trajtimin e kancerit. Njëkohësisht do të ketë depistim dhe shërbime falas për gratë nga mosha 40 deri në 60 vjeç. Kjo është një risi pasi në nivel evropian mosha është 45 vjeç. Shqipëria për shkak të riskut të lartë të kancerit të gjirit e ka ulur në moshën 40 vjeç.

Gjithashtu, në raport, në faqet e relacionit që shoqëron projektbuxhetin gjejnë përgjigje shumica e pyetjeve që ju keni. Kjo është një shumë prej 1 miliard lekë për shërbimin onkologjik dhe kardiologjinë. Pjesa më e madhe që përfitojnë pa dyshim janë edhe gratë që vuajnë nga kanceri i gjirit, ose nga kanceri i qafës së mitrës, si dhe format e tjera të kancerit. Njëkohësisht do të përmirësohet dhe Spitali i Pediatrisë në Tiranë.

Përfaqësuesve që do të marrin fjalën, u lutem të flasin shkurtimisht se cilat janë sugjerimet, që ne t’i listojmë dhe të llobojmë, sikurse tha edhe zoti Islami, sa të mundemi këto 3-4 ditë.

Faleminderit!

Mrikë Cara - Faleminderit!

Jam drejtore ekzekutive e Shoqatës për Integrimin e Zonave Informale.

Zonat informale janë e gjithë periferia e Tiranës, ato zona që janë formuar 20 vjetët e fundit, pra zonat më problematike, ku ndoshta hasen më shumë se kudo tjetër problemet sociale. Këto nuk janë as zona rurale as urbane. Unë vetëm një problem kam, se dihen të gjitha

problemet sociale të këtyre zonave të qytetit të Tiranës dhe të të gjithë Shqipërisë. Unë e mbështes atë pjesën që përmendi Mirela për buxhetimin gjinor. Në fakt në të gjitha takimet ne e kemi ngritur gjithmonë atë problematikë, që të mbështeten gratë. Ne e dimë që po bëhet një ligj për ndërmarrjet sociale nga ministria e linjës, por kemi mendimin që këto biznese sociale duhet të mbështeten me një subvencion të veçantë.

Por, gjithsesi, mendimi im dhe i atyre që unë përfaqësoj është që këto biznese sociale të mbështeten, por të jenë të sanksionuara me subvencion në një zë të veçantë. Domethënë duke i ndihmuar këto grupe grash për problemet ekonomike, kuptohet që avash-avash mund të kapërcehen dhe problemet sociale.

Faleminderit!

Mimoza Hafizi – Faleminderit!

Fjalën e ka Ines Neskaj.

Ines Neskaj - Unë përfaqësoj rrjetin e fuqizimit të gruas në Shqipëri. Në fakt u përmendën nga shumë kolegë këtu edhe disa rekomandime konkrete. Mirela e përmendi këtu që mekanizmi kombëtar i referimit kundër dhunës në familjes dhe trafikimit është shumë i rëndësishëm, është një instrument ligjor që shërben për mbrojtjen e viktimave dhe ky mekanizëm, ne duam ta theksojmë, ekziston vetëm në 17 bashki në vend. Rekomandimi ynë konkret është që në ndarjen e re administrative territoriale, që do të bëhet, duhet mbajtur parasysh që ky mekanizëm të zbatohet në të gjithë vendin, në të gjitha njësitë vendore si detyrim ligjor për të përmirësuar mbrojtjen dhe asistencën ndaj viktimave të dhunës në familje.

Gjithashtu, u përmend dhe nga grupi që mbron të drejtat e fëmijëve, zbatimi i ligjit mbi mbështetjen juridike falas. Kuptohet që dhe kjo ka koston e saj. OJF-të në nivel vendor dhe kombëtar, gjithashtu, nuk mund të mbulojnë të gjithë asistencën juridike falas për viktimat e dhunës në familje. Për këtë arsye është shumë i nevojshëm zbatimi i ligjit të mësipërm dhe mbulimi i kostove të këtij ligji. Ne kemi si sugjerim që buxheti i shtetit të shohë mundësinë që të mbështesë financiarisht studiot avokatore ose dhe avokatë privatë, të cilët kanë ofruar vullnetarisht deri më tani të mbrojnë gratë dhe vajzat, ligjërisht po flasim, në gjykata dhe që i mbështesin këto viktima të dhunës.

Për qasjen e integritit gjinor, që u përmend nga kolegët këtu, ka pasur një vendim të Këshillit të Ministrave. Me pak fjalë të gjitha ministritë duhet të përfshinin të paktën një objektiv gjinor në programet e tyre. Ky është edhe sugjerimi ynë: të përdoret kjo qasje, pra qasja

e integritit gjinor nga të gjitha ministrinë, e cila do të çojë drejt buxhetimit për të gjithë sektorët që u përmendën, këtu si: bujqësia, shëndetësia, arsimiti, transporti për të plotësuar kërkesat dhe nevojat e ndryshme të grave, por dhe të burrave.

Gjithashtu, në mënyrë që këto objektiva gjinorë të jenë të matshëm, duhet të bëhet një analizë e detajuar gjinore dhe të përcaktohen treguesit e përshtatshëm gjinorë në mënyrë që linjat e vendosura buxhetore të jenë sa më konkrete dhe të japin rezultate lidhur me barazinë gjinore.

Një sugjerim tjetër konkret është që të shihet mundësia e rritjes së numrit të strehëzave dhe qendrave, që ofrojnë mbështetje për viktimat e dhunës, sepse një qendër në nivel kombëtar nuk është e mjaftueshme. Duhet të shihet mbështetja edhe e strehëzave që menaxhohen nga OJF-të që kanë edhe ato kapacitete shumë të mira dhe standardet e tyre

Faleminderit!

Stela Tanellari – Përfaqësoj organizatën “Të ndryshëm dhe të barabartë”, që merret me ish-viktimat e trafikimit. Sugjerimi im është rritja e mbështetjes shtetërore për strehëzat që i ofrojnë këto lloje shërbimesh. Në fakt, në vitin 2011-2012 jemi mbështetur financiarisht nga Ministria e Punës për mbulim me ushqim për një periudhë 6-mujore. Për vitin 2013 kjo gjë nuk ndodhi dhe për 2014-n dhe do të donim të kishim një mbulim financiar për ushqimin jo vetëm për viktimat e trafikimit, por edhe për fëmijët e tyre, sepse ato shpesh vijnë të shoqëruar me fëmijët e tyre. Unë sugjeroj që për 2014-n të zgjatet edhe periudha në kohë, pra mbulimi për një vit.

Sugjerimi i dytë është për Ministrinë e Shëndetësisë. Ky grup vuan nga një sërë sëmundjesh. Do të donim mbulimin e shpenzimeve shëndetësore për këtë targetgrup.

Vasilika Hysi – Stela, sa kam informacion nga ministria e zotit Veliaj, është bërë kjo përfshirje që ju kërkoni, dhe pse nuk jam shumë e saktë, por besoj se në mbrëmje, ose nesër në mëngjes do të keni në emaillet tuaja informacionin që më kanë sjellë kolegët ministra. Dhe pastaj ne do të shohim se çfarë mund të tolerojmë, që të shtojmë zëra në buxhetin e projektit tuaj. Do të donim reagimin tuaj që të kemi mundësi të reagojmë. Unë, zonja Hafizi, zoti Ristani dhe zoti Islami do të jemi folës në seancën e së hënës në parlament dhe do të kemi mundësi aty të llobojmë më shumë.

Sevim Arbana - Jam Sevim Arbana, nga shoqata “Në dobi të gruas shqiptare”. Jemi një organizatë me shërbime prej 20 vjetësh për fëmijë, të rinj dhe gra paralelisht. Nuk ndahen këto problematika dhe ne i njohim shumë mirë këto fusha. Në radhë të parë, ju falënderoj për këtë

gjest edhe pse formal, por është hap i mirë drejt zhdukjes së formalizmit! Unë kisha dy sugjerime. Njëri për Ministrinë e Punës. Së pari, në luftën kundër dhunës ndaj grave, një nga faktorët kryesorë është dhunuesi, të cilit ne i kemi krijuar një komoditet shumë të madh në të gjithë këto vite.

Strehëzat kanë bërë punët e tyre dhe vazhdojnë ta bëjnë. Unë jam një nga flamurtaret e para që kam ngritur zërin për të bërë edhe një strehëz për burrat, dhe në 2014 duhet ta realizojë patjetër këtë, që në 2015 ne të kemi një strehëz për burrat. Ne jemi gati që në partneritet me ministrinë të japim edhe kontributin tonë të vogël.

Një shqetësim tjetër ka të bëjë me faktin që zyra jonë në pozicionin e saj gjeografik është para një institucioni, atij të përmbarimit. Duke qenë se ne japim shërbime për gratë dhe fëmijët, një fluks i madh grash na vijnë të na informojnë se ato nuk arrijnë të vjelin detyrimet ushqimore nga bashkëshortët e ndarë. Këtu luajnë rolin e tyre korrupsioni, puna e zezë, deklaratimet e pabëra etj. Ndaj Ministria e Drejtësisë duhet të shtojë staf ose performancën profesionale që këto gra të mos vuajnë kaq shumë për të marrë të drejtën e tyre. Vetëm 40% e tyre e marrin, ndërsa 60% e tyre enden me vite dhe s'marrin gjë.

Edlira Çepani – Përshëndetje. Vij nga rrjeti i grave “Barazi në vendimmarrje”. Unë do të doja të bëja një falënderim për Aleancën e Grave Deputete, sepse që me krijimin e saj janë ndërmarrë nisma të njëpasnjëshme për dëgjimin e zërit të shoqërisë civile dhe organizatave të ndryshme të grave. Ne detyrohemi sot të flasim në përgjithësi dhe pa shifra, por do mundohemi ta bëjmë. Unë pashë te buxheti për Kuvendit 2 pika të ndryshme: menaxhimi dhe administrimi dhe veprimtaria ligjvënëse. Do të sugjeroja, nëse nuk është bërë ende, që të vendoset një buxhet i veçantë për funksionimin e Aleancës së Grave Deputete. Është vërtet një nismë e cila vjen spontanisht nga gratë dhe në një farë mënyre një nismë sociale private e grave, por nga ana tjetër, një nismë që i përket Kuvendit dhe shoqërisë shqiptare, e cila ka nevojë për një buxhet të shtetit shqiptar për të funksionuar, për të mos qenë e varur vetëm nga donatorët e huaj, të cilët sot janë e nesër mund të mos jenë.

Po rikujtoj edhe njëherë rritjen e buxhetit për strehëzat për gratë e dhunuara. Për Ministrinë e Shëndetësisë do të sugjeroja parashikimin e një fondi për luftën kundër kancerit të gjirit, ku një pjesë të jetë investimi në infrastrukturë. Kemi 50% të popullsisë të përbërë prej grash dhe gjysma e kësaj popullsie është në moshën që duhet të bëjë vizitën çdo vit dhe ne nuk kemi paratë e nevojshme të shpërndara në nivel kombëtar, për t'ua mundësuar këtë vizitë. Ndaj

investimi i parë duhet në infrastrukturë. Do të flisja edhe për subvencionimin e këtyre vizitave, koston që kanë këto për kancerin e gjirit dhe fushata sensibilizuese.

Doja të flisja edhe për asistencën ligjore falas, të cilën ne nuk e gjetëm në asnjë vend të buxhetit. Rritja e buxhetit në nivel vendor për çështjet e grave dhe të integritit të tyre edhe në tregun e punës, edhe në qendrat ditore që kanë për synim formimin e këtyre grave është e rëndësishme. Për Ministrinë e Ekonomisë do të kisha një sugjerim që të rriste pak buxhetin. Do t'i sugjeroja që të ngrinin buxhetin me SME-të, sepse ai është biznesi që i fuqizon më tepër gratë. Në lidhje me kuotën 5 mijë lekë, unë nuk e kisha parë, por nga eksperiencia personale dhe e tre personave të stafit tim, të cilët kanë lindur të gjithë në vitin 2013, kjo është një kuotë që është marrë nga sigurimet shoqërore, ne na është kaluar dhe është e rëndësishme të vazhdojë të kalohet, sepse është një urim që bëhet në të gjithë botën, jo vetëm si traditë shqiptare. Ne kemi këtu një shumë simbolike, por në shtete të tjera, qoftë Italia, qoftë Greqia apo Maqedonia, shifrat janë shumë të mëdha, të cilat mbështesin. Është një buxhet që shteti ia jep fëmijës në ditën e parë të jetës së tij. Këto ishin sa u përket shpenzimeve.

Sa u përket hyrjeve të buxhetit, unë do të kisha një sugjerim në lidhje me paketën fiskale. Duke qenë se pjesa më e madhe e tregut të punës mbulohet nga bujqësia, do të thosha të mundoheshim të lobonin, që rritja e çmimit të naftës të mos jetë aq e lartë sa ç'është menduar, sepse kjo ndikon drejtpërdrejt në veprimtari, ndikon drejtpërdrejt në punësimin e grave në sektorin bujqësor, ndikon drejtpërdrejt në rritjen e kostos së shërbimeve publike. Ky është mendimi im personal.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Më falni, por mua më duhet të largohem, pasi duhet të jem në një takim të rëndësishëm me zonjën Hafizi, dhe drejtimin do ta marrë kolegu Ristani, që është nënkryetar i komisionit! Unë ju premtova se do t'jua dërgoj komentet e ministrave të linjës. Ju kërkoi ndjesë edhe një herë dhe ju falënderoj shumë!

Ani Rusi – Vij nga shoqata “Refleksione”, e cila menaxhon prej 6 vjetësh një projekt për ngritjen e strukturave lidhur me zbatimin e ligjit kundër dhunës ndaj gruas. Ky projekt implementohet edhe me rrjetin e shoqatave partnere kundër trafikimit dhe dhunës ndaj gruas. Ne sot këtu do të kishim ardhur nëse buxhetimi gjinor do të ishte i realizuar, sepse buxhetimi gjinor është baza që ne si shoqata do të shihnim konkretisht si do të ishte realizuar ky buxhetim gjinor. Sa kohë ky buxhetim është ende në procesin e implementimit ne jemi në errësirë, pasi nuk e

dimë se çfarë do të ndodhë me zërat e buxhetit. Megjithatë, me këtë errësi, unë dua të ngre vetëm dy çështje. Do të ishte e udhës që të parashikohet edhe aksesimi i qytetarëve te psikologët dhe punonjësit socialë. Është bërë së fundi përjasja për luftën e dhunës me bazë gjinore, por kjo nuk bëhet vetëm duke luftuar viktimën, por duke edukuar edhe dhunuesin, pra burrat dhe djemtë.

Së dyti, doja të dija nëse ka ndonjë zë lidhur me mbështetjen e grave dhe fëmijëve në zonat e ngujuara. Hakmarrja është një fenomen i frikshëm që po zgjerohet dhe, nëse shkojmë në zonat e Veriut të Shqipërisë, gjejmë dhjetëra fëmijë të ngjuar me nënat dhe motrat e tyre. Ka donacione të huaja që i ndihmojnë këto raste, por kjo duhet mendohet edhe në buxhet përmes një zëri të posaçëm. Duhet të kishim në shumë njohuri, për të qenë më të dobishëm me mendimet tona.

Gentian Opre - Doja t'ju falënderoja për sugjerimet dhe t'ju premtoj përgjegjshmërinë për çështjet që ju ngritët në këtë seancë dëgjimore. Po ritheksoj edhe njëherë rëndësinë e buxhetit të programit afatmesëm, që ta përdorni në mënyrë aktive, në mënyrë që të jetë pjesë e vendimmarrjes dhe të monitorojnë zbatimin e atyre që shkruhen në letër. Unë jam vetë drejtor i programimit buxhetor dhe do të kem kujdes të veçantë për fushat specifike që ju ngritët sot dhe që mbrojnë në vazhdimësi në punë tuaj të përditshme. Shpreh angazhimi tim të plotë për të ndjekur këtë proces me kujdes, duke u bërë pjesë e një skuadre për arritjen e qëllimit.

Arben Ristani – Cilat janë tri gjëra që ju mund t'i realizoni në të gjitha këto?

Gentian Opre – Kërkesat që janë parashtruar këtu dhe në komisionet e tjera përgjegjëse duhet të përcillen te Komisioni i Ekonomisë, duke qenë se ai është komisioni përgjegjës. Duke pasur parasysh edhe kërkesat e tjera, ato do të diskutohen të gjitha.

Arben Ristani - Pastaj janë të gjithë të lumtur dhe të kënaqur.

Kastriot Islami – Para se ta mbyllë kryetari i seancës, unë do t'ju sugjeroja nënkomisionit për të drejta e njeriut t'ju dërgojë një informacion me shkrim zonjës kryetare. Dërgoni një informacion mbi aktivitetin tuaj, bazën ligjore dhe konventat në respekt të së cilave ju kryeni aktivitetin. Së dyti, në çfarë projektesh kërkoni t'ju mbështesim. Të jemi të sinqertë, këtë vit do të jetë shumë e vështirë që Komisioni i Ekonomisë të marrë në konsideratë ndonjë kërkesë tuajën. Me të drejtë u tha se ka errësi totale dhe nuk e kemi shumë të qartë se cilat janë projektet. Ka errësi se në çfarë mase kërkohet. E mira është të futeni në ushtrim për vitin 2015 dhe që të futeni për këtë, ne si nënkomision mund të bëjmë presionin tonë. Unë ua them me sinqeritet se duhet ta bëni këtë në ministri, duke na vënë në dijeni edhe ne.

Nëse shkoni me një listë projektesh me buxhetin përkatës te ministria përkatëse, duhet t'ia dërgoni me Cc edhe kryetares. Ne kështu e kemi më kollaj që të thërrasim në interpelancë edhe ministrin, për të na dhënë shpjegim nëse nuk i mbështet projektet tuaja, por duam që kjo të bëhet dhe ju të përfitoni nga mundësia që ne kemi për të bërë presion si nënkomision për të drejtat e njeriut, nuk ka rëndësi të grave apo fëmijëve. Nëse keni ndonjë gjë konkrete, mundësisht na i dërgoni që sot dhe ne t'ia përcjellim Komisionit të Ekonomisë. Edhe nëse keni nevojë për nisma ligjore, na thoni! Çfarëdo idesh që të keni, na i dërgoni! Ky është një nënkomision modest, por ne do të mundohemi dhe do të bëjmë presion, meqë kjo është një shtyllë shumë e rëndësishme edhe në kuadrin e Këshillit të Europës, i cili nuk e heq monitorimin ndaj Shqipërisë për këto arsye.

Arben Ristani – Po bëj një shtesë të vogël. Jemi shumë afër miratimit të buxhetit dhe unë nuk besoj se ne do të kemi ndonjë ndryshim të shpejtë këto ditë për të marrë përgjigje për problemet që u ngritën. Por, e rëndësishme është praktika që krijohet kur ne ulemi së bashku dhe shkëmbejmë mendime. Mendoj se në të ardhmen kjo mund të vazhdojë për mirë.

Gentian Opre - Unë mendoj se është një mundësi shumë e mirë që po dialogojmë, por mendoj se ka disa nisma që këtë vit mund të ndikojmë. Çështja e fondit për OJF-të në Ministrinë e Mirëqenies Sociale do të kërkonim të dyfishohej dhe besoj se me shumë pak punë, si me deputetët majtas, djathtas dhe të LSI-së mund të gjendet një mirëkuptim, sepse nuk bëhet fjalë për ndonjë fond të jashtëzakonshëm. E dyta është se çdo ministri duhet të ketë një fond sado të vogël, që ta japë për nisma që vijnë nga shoqëria civile që të nisim t'i ndryshojmë gjërat së bashku: OJF dhe qeveri. E treta, mendoj se këtu duhet bërë luftë, është çështja e atij 5 mijë lekëshit. Nuk mund të heqim minimumin që qeveria mund të bëjë për ardhjen e një fëmije në jetë. Kjo nxit nënat, por ky është edhe minimumi që bën shteti.

Arben Ristani – Lidhur me pjesën e këtij 5 mijë lekëshit, mesa kuptoj unë, është fond i Ministrisë së Brendshme për t'ia shpërndarë pushtetit lokal. Ky është fond i dedikuar? Nuk varet nga ministri, nëse i pëlqen apo nuk i pëlqen ta japë?

Gentian Opre - Po, është një zë i veçantë në shërbimin e gjendjes civile dhe është pjesë e kuadrit ligjor në fuqi. Në këtë fond ka pasur gjithmonë deficienca në të kaluarën.

Arben Ristani - Mos u merrni më me të kaluarën! Jo se kam unë ndonjë gjë, se s'kam qenë pjesë e qeverisë fare. Nëse ka pasur probleme në të kaluarën, nuk duhet të ketë patjetër edhe në të ardhmen.

Kastriot Islami – E para, në bazë të numrit që u tha këtu, duhet të ketë një fond për 2014-n. Nëse ka një numër të parashikuar, shumëzim për pesë vjet, ai fond të jetë për 2014-n. Nëse keni pak më shumë lekë, thoni se kjo është për të shlyer detyrimet e kaluara. Mos i përziëni të dy fondet!

Gentian Opre – Parimi është që të paguhen fillimisht detyrimet e prapambetura, pastaj të kalohet tek të rejat. Unë vetë jam përfitues i këtij fondi dhe nuk e kam marrë.

Kastriot Islami – I bie të mërzisim edhe ata që lindin tani, dhe jo vetëm ata që janë bërë 10-vjeçarë. Mua nuk më duket normale kjo. Ju me një VKM mund të thoni se ky buxhet është për lindjet e reja, kurse pjesa tjetër për detyrimet e kaluara. Nuk kemi mundësi t'i shlyejë të gjitha këtë vit. Por, nëse ju veproni kështu, të jeni të sigurt se kjo nxit edhe korrupsionin.

Gentian Opre – Ky është parimi që ndiqet edhe në thesar, paguhet fatura më e parë.

Arben Ristani – Unë jam jurist dhe nuk jam ekonomist, por nuk lëshohet faturë për lindjen.

Gentian Opre – Lëshohet një certifikatë nga gjendja civile për të marrë paratë në bankë dhe nga kjo lind e drejta.

Kastriot Islami – Me këtë logjikë, në janar që ditën e parë ky fond bëhet zero menjëherë.

Mimoza Hafizi – Lidhur me 5-mijë lekëshin, ky fond për lindjet i kalohet pushtetit vendor dhe ata e përcaktojnë vetë kujt t'ia japin dhe kujt jo dhe ka një diskriminim shumë të ndjeshëm. Nuk e marrin shtresat më vulnerabël dhe e marrin ata që nuk duhet ta marrin.

Arben Ristani – T'i marrim gjërat me radhë. Të shkojë fondi te pushteti lokal, pastaj në të bashkëpunojmë së bashku që ai fond që shkon të pushteti lokal t'i shkojë nënës në dorë. Ikim bashkë që nesër në bashki, por së pari të shkojë fondi për këtë gjë.

Ndoshta do të ishte e udhës që kërkesat që keni me shkrim t'ia adresoni Kuvendit dhe të shohim se çfarë mund të bëjmë. Unë besoj se kjo mënyrë pune mund të jetë një model i mirë që të vazhdojmë më tutje. Madje, dhe për gjëra të tjera, unë jam disponibël për t'ju ndihmuar. Të njëjtin përkushtim do të keni edhe nga zonja Hysi edhe nga gjithë deputetët e tjerët.

Faleminderit!

MBLEDHJA MBYLLET